




REPUBLIKA E KOSOVËS / THE REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dpj. Dep. Dep.	DPK
Nr. Ifaq Broj stranica Nr. pages	02
Nº Prot. Br. Prot. Prot No.	
Data Datum Date	
03-02/3449/1 24.10.2012	
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**



Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.10.2017, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-02-2436-17, për Zyrtarin e lartë z.Korab Mushkolaj-Konsull – Ministria e Punëve të Jashtme, për shkak se ështëshmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-2436/17, për Zyrtarin e lartë, z.Korab Mushkolaj, Konsull Ministria e Punëve të Jashtme, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsion i ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.Korab Mushkolaj (DPK-03-02-2985-17), dhe pastaj ai ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë, z.Mushkolaj është deklaruar se do të angazhoj dikën që të bëjë ndryshimet e nevojshme, për shkak se ai është me mision zyrtar jashtë vendit.

Ndërkohë, z.Mushkolaj, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar informacionet mbi ndryshimet në biznesin Agjensioni turistik "D..Travel" dhe N.Sh."Kodeksi" (DPK/Dpki-03-02/2436/17) të bëra në Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në të cilin shihet se, z.Korab Mushkolaj tashmë ka hequr dorë nga funksioni menaxhues në këto biznese privat, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

  
/ Shaip Havolli /

